

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE "SNUPI" SH.P.K**

Bazuar ne Aktin e Themelimit dhe ne zbatim te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", veprimtaria e shoqerise "SNUPI" sh.p.k. do te organizohet e drejtohet ne baze te normave te ketij statuti.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**

Parimet dhe normat e ketij statuti shprehin vullnetin e Ortakve dhe kerkesat e Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Ato rregullojne aktivitetin, strukturen e shoqerise dhe jane taksative.

**Neni 2**

Per probleme dhe ceshtje qe nuk gjejne zgjidhje ne kete statut, zbatohen kerkesat e Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" , Ligjit Nr. 9723 dt 30.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" dhe dispozitat e Kodit Civil.

**PERSONALITETI DHE SELIA**

**Neni 3**

Shoqeria " SNUPI " sh.p.k eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me kapital te huaj. Ajo eshte person juridik e huaj dhe ushtron aktivitetin e saj ne te gjithe territorin. Veprimtaria e saj i nenshtrohet ligjit shqiptar.

**Neni 4**

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen Tirane , Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajes, Pallati 100 Vitrinat, Kati 3, Nr.223, Shkalla 2. dhe adresa mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakve. Çdo ndryshim i Selise kerkon regjistrimin ne QKR. Shoqeria mund te krijojte seli te tjera dhe filiale te saj si ne Shqiperi ashtu dhe jashte territorit shqiptar, ne perputhje me ligjin.

**Neni 5**

Shoqeria "SNUPI" sh.p.k vepron me ane te strukturave te saj. Veprimet e kryera prej tyre shprehin vullnetin e shoqerise dhe e kushtezojne ate te mbaje pergjegjesi ndaj te treteve.

**Neni 6**

Shoqeria "SNUPI" sh.p.k do te ushtroje veprimtarine e saj per nje afat kohor te pacaktuar. Ajo merr persiper te drejta dhe detyrime nga momenti i themelimit dhe regjistrimit te saj ne organet kompetente.



## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

**Neni 7**

Shoqeria "SNUPI" sh.p.k ka per objekt:

Call center, Tele-marketing

Per te gjithë aktivitetet per ushtrimin e te cilave kerkohet license e posacme , shoqeria do te ushtroje aktivitetin pasi me pare te jete pajisur me licensen perkatese nga organet kopetente.

## KAPITALI I RREGJISTRUAR DHE KUOTAT

**Neni 8**

Kapitali i Regjistruar i shoqerise "SNUPI" sh.p.k eshte 1,000 leke. Kapitali i Regjistruar do te perbehet nga 1 kuote, ku vlefte nominale e kesaj kuote eshte 1,000 leke.

Kapitali i Regjistruar zoterohet teresisht nga Z Mykhailo Tanchuk, Ortak i Vetem, i cili zoteron 100% te kapitalit.

**Neni 9**

Kapitali i Rregjistruar dhe numri i ortakeve mund te rritet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, qe perfaqeson jo me pak se 3/4 e kuotave te Kapitalit te Regjistruar.

Ne rast Zmadhimi te Kapitalit te Regjistruar çdo ortak mund te abstenoje ne nenshkrimin e kapitalit te ri duke ruajtur kuoten e meparshme te tij, ose te terhiqet nga shoqeria brenda 30 ditesh nga vendimi i marre per zmadhimin e kapitalit.

Kuotat emerore te Kapitalit te Regjistruar jane te transferueshme me dokument noterial midis te gjalleve ose trashegimtareve te tyre sipas ligjit per trashegimine dhe kerkesave te nenit 73 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 10**

Ortaku qe deshiron t'i tjetersoje nje te treti kuotat e tij ose nje pjese te tyre, duhet te depozitoje kerkesen e tjetersimit nepermjet nje letre rekomande duke i bere te njohur shoqerise dhe ortakeve te tjere çmimin dhe menyren e tjetersimit. Ortaket ekzistues kane te drejten e parablerjes.

**Neni 11**

Ne rast se njeri nga ortaket heq dore qofte edhe pjeserisht nga blerja e kuotave te ofruara, kuotat e refuzuara shtohen ne favor te ortakeve te tjere ne raport me pjesemarrjen e tyre ne Kapitalin e Regjistruar.

Kuoten e ofruar per blerje ortaket detyrohen ta blejne teresisht.

**Neni 12**



Nese asnjeri nga ortaket nuk ushtron te drejten e parablerjes dhe nese shoqeria nuk komunikon vendimin e saj brenda 30 ditesh nga depozitimi i kerkeses, tjetersuesi ka te drejte t'i ofroje kuoten e vet nje te treti por jo me çmim me te vogel nga ai i ofruar i shoqerise.

Shoqeria duhet te jape pelqimin e saj per pranimin e ortakut te ri brenda afateve logjore, ne te kundert miratimi konsiderohet i dhene.

Çdo kalim i kuotave ne kundershtim me keto norma nuk mund te rregjistrohet ne librin e ortakeve te shoqerise dhe as ne QKR.

## MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKVE

### **Neni 13**

Ortaket kane te drejte te ndajne ne formen e dividendit pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise ne raport me kuotat e zoteruara ne Kapitalin e Regjistruar te saj.

### **Neni 14**

Shoqeria mund t'u shperndaje fitim ortakve vetem ne se pas pagimit te dividendit ekzistojne keto kushte :

- a.- Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj
- b.- Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme nga te tretet brenda 12 muajve ne vazhdim .

Per plotesimin e ketyre kushteve Administratori, ne pergjegjesine e tij personale, leshon nje Certifikate te aftesise paguese.

## ASAMBLEJA

### **Neni 15**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese, ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakëve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Asambleja e Ortakeve konsiderohet prezent me pjesemarrjen e 51% te zoteruesve te Kapitalit te Regjistruar.

Çdo ortak ka te drejten e nje vote, per cdo kuote qe zoteron ne Kapitalin e Regjistruar.

Ortaku i Vetem merr vendime ne emer te Asamvlese se Ortakve.

### **Neni 16**



Ne asamble marrin pjese ortaket qe rezultojne te regjistruar ne librin e shoqerise.

Çdo ortak mund te perfaqesohet nga nje person tjetër ne asamble me autorizim me shkrim. Perfaqesuesi i tij mund te jete ortak apo nje person i trete, por jo administrator i shoqerise. Autorizimi jepet vetem per nje mbledhje te asamblese si dhe ne mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Asambleja e Zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e aktivitetit financiar te shoqerise.

Asambleja e Jashtezakonshme thirret per vendime urgjente ne cdo rast qe administratori e ndjen te nevojshme ose me kerkesen e çdo ortaku qe perfaqeson 10% te Kapitalit te Rregjistruar.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne shumice te zakonshme , asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave . Ndersa kur vendimet kerkojne shumice te kualifikuar ortaket pjesemarres ne asamble duhet te zoterojne me shume se gjysmen e totalit te kuotave.

Ne mungese te formaliteteve te mesiperme, asambleja konsiderohet rregullisht prezent me pjesemarrjen e 100% te pjeseve te Kapitalit te Rregjistruar. Secili nga pjesemarresit mund te kundërshtojë diskutimin e çështjeve mbi te cilat mendon se nuk është informuar plotësisht apo kur çështja bie ndesh me nenet e statutit dhe te Ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

#### **Neni 17**

Asambleja kryesohet nga Administratori i cili zgjidhet midis ortakeve deri ne doreheqjen ose ne shkarkimin e tij. Ne mungese te tij ajo drejtohet nga ortaku me i madh ne moshe ose nga nje person i caktuar nga shumica e ortakeve te pranishem.

Per mbajtjen e proces verbalit, Administratori emeron nje sekretar, me perjashtim te rasteve kur proces verbali mbahet nga nje noter.

#### **Neni 18**

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te nenit 83 te ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne se te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

#### **Neni 19**





Te gjitha vendimet e asamblese do te verbalizohen ne librin perkates dhe proçes verbali duhet te firmoset nga administratori ose nga sekretari i emeruar nga ai, me perjashtim te rasteve qe sipas ligjit duhet te mbahet nga nje noter.

Kundershtimet e mundshme te vendimeve duhet te paraqiten ne baze te Ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe Rregjistrin Tregtar.

## ADMINISTRIMI

### **Neni 20**

Shoqeria administrohet nga administratori Z Mykhailo Tanchuk i emeruar me date 02/03/2021 me nje afat 5 vjet, me te drejte perseritje.

Administratori ka fuqi te pakufizuara per veprime administrative ne shoqeri dhe ne marredhenie me te tretet, me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe statuti ja njeh asamblese.

### **Neni 21**

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit jane sipas nenit 95 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### **Neni 22**

Administratori eshte perfaqesues ligjor i shoqerise. Per çdo ndryshim te tagrave perfaqesuese te tij, njoftohet QKR per rregjistrim.

### **Neni 23**

Administratori kryen detyrimin e besnikerise dhe mban pergjegjesi per çdo veprim apo mosveprim sipas pikave 2.3 dhe 4 te nenit 98 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### **Neni 24**

Shperblimi i Administratorit caktohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne se shoqeria eshte ne veshtiresi financiare , Asamblea mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratorit dhe kjo publikohet se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **Neni 25**

Firma per pagesat ne emer te shoqerise i takon Administratorit.

## RAPORTET E PUNES

### **Neni 26**

Administratori gezon te drejten e punesimit te personave te tjere ne shoqeri dhe te nenshkruaje kontraten e punes.



**Neni 27**

Raportet e shoqerise me te punesuarit rregullohen me ane te Kontrates se Punes e cila duhet te permbaje rigorozisht te drejtat dhe detyrat qe Kodi i Punes iu njeh paleve.

Te punesuarit ne Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per moszbatimin e detyrave te caktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi administrative apo penale per demet e shkaktuara nga moszbatimi i detyrave te tyre.

**KONTROLLI I BRENDSEHEM****Neni 28**

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem te aktivitetit te saj me Eksperte Kontabel te Regjistruar.

Asambleja e ortakeve, mund te emeruje nje ose me shume eksperte kontabel. Funkzioni dhe kohezgjatja ne detyre rregullohet nga dokumenti i emerimit dhe kontrata ndermjet paleve.

**BILANCI DHE FITIMI NETO I SHOQERISE****Neni 29**

Aktiviteti financiar i shoqerise fillon me krijimin e saj dhe mbyllet ne 31 Dhjetor te çdo viti.

Ne fund te çdo viti Administratori merr masa per hartimin e bilancit te aktivitetit sipas afateve dhe menyrave te parashikuara nga ligji "Per kontabilitetin" dhe SKK ne fuqi. Ai harton nje relacion mbi mbarevajtjen e shoqerise gjate vitit.

**Neni 30**


Bilanci i shoqerise dhe dokumentacioni i nevojshem duhet te miratohen nga Asambleja e Zakonshme e Ortakeve brenda gjashte muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

**Neni 31**

Fitimi neto i shoqerise do te ndahet ne raport me kuotat e zoteruara ne Kapitalin e Regjistruar.

Fitimi neto qe rezulton nga bilanci vjetor do te ndahet:

- a) 5% shkon ne fondin e Rezerves se Domosdoshme , perderisa te plotesohet 1/10 e Kapitalit te Regjistruar.
- b) Pjesa tjeter vihet ne dispozicion te asamblese per t'ju ndare ortakeve ne proporcion me kuotat qe zoterojne ne Kapitalin e Rregjistruar, apo ne destinacione te tjera si zmadhim kapitali, ose krijim rezervash te ndryshme etj.





**SHKRIRJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI****Neni 32**

Aktiviteti i shoqerise mund te mbyllet perpara afatit te parashikuar ne aktet themeluese kur bilanci i saj rezulton jo fitimprures dhe ne çdo rast tjetër me vendim te asamblese se ortakeve ose me kerkesen e ortakeve qe perfaqesojne 10% te Kapitalit te Rregjistruar.

**Neni 33**

Ne rast falimentimi te shoqerise asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit dhe emeron nje ose me shume likuidues duke percaktuar dhe pagesen e secilit.

**Neni 34**

Per çdo rast konflikti te shoqerise me te tretet dhe ndermjet ortakeve dhe ne rast mosarritje te konsensusit, çdonjeri gezon te drejten e prezantimit te çeshtjes organeve kompetente gjyqesore dhe arbitrazhit nderkombetar.

**DISPOZITA TE FUNDIT****Neni 35**

Te gjitha vendimet, kundershkrimet dhe sugjerimet e organeve drejtuese te ortakeve te shoqerise, do te evidencohen ne nje liber protokolli, i cili do te kete vlere ruajtje sipas ligjit mbi arkivat.

**Neni 36**

Ndalohet konkurrenca midis ortakeve per te njejten veprimtari

**Neni 37**

Shoqeria ka vulen e saj, stema e se ciles permban shkrimet e nevojshme qe tregojne emrin e shoqerise.

**Neni 38**

Ky statut u hartua ne tre kopje origjinale, miratohet t dhe firmoset rregullisht nga Ortaku i Vetem :

**Z . MYKHAILO TANCHUK.**

Tirane me 02/03/2021

